



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

V E N D I M

Nr. 11 Datë 05. 09. 2017

“ PËR MIRATIM E LEJES PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR ENERGJI ELEKTRIKE” SUBJEKTIT “LAJTHIZA INVEST” SH.A.

Në mbështetje të nenit 7 pika 2 ,të nenit 50, nenit 51, nenit 52, të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika f, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, “ Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike , që nuk janë objekt konçesioni”, miratimin paraprak Nr. 5119/7, datë 10.10.2016 të MEI, për paisjen me leje të përdorimit të burimit uJOR të subjektit **“LAJTHIZA INVEST” SH.A.** , me propozim të A.B.U Drin- Bunë, miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe oponentës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore, Këshilli i Basenit UJOR Drin- Bunë,

V e n d o s i:

1-Miratimin e lejes së subjektit **“LAJTHIZA INVEST” sh.a** me administrator Z.Thanas SIVERI, për përdorim të burimit uJOR **Përroi i Sërriqes, Satrave dhe të Vales**, me derdhje në lumin Drin për prodhim energjie elektrike në Fshatin Qami, Bashkia Kukës, Qarku Kukës.

Sipas studimit të paraqitur nga subjekti HEC QAMI 1 do të ketë këto të dhëna:

Vepra e marrjes Nr.1 (Prr.Sërriqës)	$X_1 - 44\ 30\ 801;$	$Y_1 - 46\ 55\ 305;$	$Z_1 - +568m$
Vepra e marrjes Nr.2 (Prr.Satrave)	$X_2 - 44\ 32\ 049;$	$Y_2 - 46\ 56\ 947;$	$Z_2 - +568m$
Vepra e marrjes Nr.3 (Prr.Vales)	$X_3 - 44\ 32\ 899;$	$Y_3 - 46\ 59\ 203;$	$Z_3 - +563m$
Koordinatat e godinës së centralit:	$X - 44\ 33\ 748;$	$Y - 46\ 60\ 722;$	$Z - +412m;$
Koordinatat e pikës së shkarkimit:	$X - 44\ 33\ 748;$	$Y - 46\ 60\ 722;$	$Z - +412m;$
Prurja mesatare e burimit:	$Q_{1mes}=0.874m^3/sek;$	$Q_{2mes}=0.353m^3/sek;$	$Q_{3mes}= 0.136m^3/sek;$
Sasia e ujit që kërkohet të përdoret:	$Q_{llog}= 1.5m^3/sek;$		
Prurja ekologjike:	$Q_{ekol}=0.13m^3/sek;$		
Prurja që shkarkohet:	$Q = 1.5 m^3/sek.$		

2-Leja e përdorimit të burimit uJOR për prodhim energjie elektrike jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zone dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e këtij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

Sekretari

Martin PLLUMBI

Kryetar

Paulin RADOVANI

